

PLANI PËR MENAXHIM ME MJEDISIN JETËSOR

Për projektin

**“Përmirësimi i qasjes dhe atraktivitetit në “Vendbanimin liqenor dhe me diell të
Mantovës dhe rethinës”**



Korrik 2018, Konçe

Përmbajtja

1. HYRJA.....	3
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	5
2.1 HYRJA	5
2.2 LOKACIONI I PROJEKTIT	5
2.3 PËRSHKRIMI TEKNIK DHE TEKNOLOGJIK I AKTIVITETEVE.....	8
3. KORNIZA POLITIKE, LIGJORE DHE ADMINISTRATIVE.....	10
3.1 KONSULTA PUBLIKE PËR PROJEKTIN RETH PLANIT PËR MENAXHIMIN ME MJEDISIN JETËSOR	13
4. TË DHËNAT KRYESORE	14
5. NDIKIMI MBI MJEDISIN JETËSOR	20
5.1 EMETIMET	20
5.1.1 Emetimet në ajër	20
5.1.2 Ndotja e ujit.....	22
5.2 KRIJIMI DHE MENAXHIMI I MBETURINAVE	23
5.3 EMETIMET NË TOKË	25
5.4 ZHURMA DHE VIBRIMET	25
5.5 SHUMËLLOJSHMËRIA (FLORA DHE FAUNA)	26
5.6 NDIKIMET SOCIALE.....	27
6. MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE	28
6.1 AJRI.....	28
6.2 UJI.....	28
6.3 TOKA	29
6.4 ZHURMA.....	30
6.5 MBETURINAT	30
6.6 SHUMËLLOJSHMËRIA BIOLOGJIKE (FLORA DHE FAUNA).....	31
7. PLANI PËR MENAXHIMIN E MJEDISIT JETËSOR DHE ASPEKTET SOCIALE	32
8. AKTIVITETET E MONITORIMIT.....	51

1. HYRJA

Projekti për konkurrencën lokale dhe rajonale (KLR) është një operacion katërvjeçar për investim i mbështetur nga Bashkimi Evropian që shfrytëzon fonde nga IPA 2 të dedikuara për konkurrencë dhe inovacion në Maqedoni. Me KLR do të menaxhohet si me fond hibrid të trustit dhe do të përbehet nga katër komponenta dhe do të realizohet nga ana e Bankës Botërore dhe Qeverisë të Republikës të Maqedonisë. Projekti do të mundësojë mjete për investim dhe ndërtim të kapaciteteve për mbështetje të rritjes të sektorit, për investim në destinacione dhe krijimin e prosperitetit në destinacione të caktuara. Në nivel rajonal dhe lokal, projekti do të mbështesë destinacionet e zgjedhura turistike në vend përmes kombinimit të ndihmës teknike për përmirësimin e menaxhimit të destinacionit, për investim në infrastrukturë dhe investim në lidhje dhe inovacion. Investimi do të bëhet përmes skemës të granteve për aktorët e turizmit rajonal, si për shembull komunat, institucionet, OJQ dhe sektori privat. Ky plan i menaxhimit me mjedisin jetësor dhe aspektet sociale është përgatitur për aktivitetet që janë kryer për nën-projektin Përmirësimi i qasjes dhe atraktivitetit në "Vendbanimin liqenor dhe me diell të Mantovës" dhe rethinës. PMMJ paraqet dokumentin për mjedisin jetësor që përbëhet nga përshkrimi i projektit, detajet teknike, vëllimi, mjedisi dhe lokacioni, në bazë të të cilave vlerësohet rreziku në mjedisin jetësor dhe rreziqet sociale dhe masat për shmangien dhe zbutjen e të njëjtave. Zbatimi i masave për zbutjen e rreziqeve të paraqitura dhe problemeve që janë theksuar në PMMJ është i detyrueshëm. PMMJ është përgatitur në përputhje me Kornizën për menaxhim të mjedisit jetësor dhe çështjet sociale (ESMF) e cila e rrregullon realizimin e projektit. Të gjithë aktivitetet të nën-projektit duhet të realizohen në përputhje me ESMF.

Liqëni i Mantovës sipas të gjitha karakteristikave konsiderohet si lokalitet turistik me potencial më të madh në rajonin e Komunës të Konçes, respektivisht liqënit dhe rethinës të tij, është resurs turistik në të cilën komuna planifikon të zhvillojë turizmin. Liqeni ndodhet në largësi prej 15 km nga Konçe, 18 km nga Radovishi dhe 25 km nga Shtipi me çrast e bën atraktive për vizitorë nga rethina më e gjërë. Shumë afër liqënit, gjendet "Vendbanimi liqenor dhe me diell i Mantovës" me planin urbanistik ekzistues.

Me nën-projektin do të eliminohet mungesa e qasjes dhe atraktivitetit deri të bukuritë natyrore në rethinën e liqenit të Mantovës, duke përfshirë edhe rehabilitimin e rrugës, mapimin dhe shënimin e rrugëve për këmbësorë, vendosjen e ndriçimit, pajisjet urbane dhe promovimin e lokalitetit. Segmentet prioritare të cilat targetohen: turistët nacional dhe rajonal për pushim të shkurtër, dhe turistët aktiv të pavarur. Në fillim do të synohen udhëtimet njëditore, me mundësi të vazhdohet qëndrimi.

Natyra e projektit e synon liqenin e Mantovës, respektivisht tejkalimi i kufizimit për qasje dhe disponueshmëri të bukurive natyrore autentike dhe aktivitetet të cilat janë një resurs i çmuar në komunë, të cilat nuk janë të eksponuara në kuadër të destinacionit. Në këtë moment janë kufizuar investimet në infrastrukturë dhe janë të dedikuara drejtë aktivitetëve të synuara, dhe

prandaj nuk është dhënë prioritet në zhvillimin e destinacioneve turistike dhe atraksioneve në natyrë.

Me tejkalimin e këtyre mangësive, nën-projekti do të kontribuojë drejtë rritjes të atraktivitetit respektivisht tërheqjes, e kështu edhe rritjes të numrit të turistëve dhe aktiviteteve ekonomike në komunë.

2. Përshkrimi i projektit

2.1 Hyrja

Pasi u vërtëtua potenciali turistik i akumulimit të Mantovës, komuna e Konçes filloi me përgatitjen e dokumentancionit projektues me qëllim të përmirësimit të disponueshmërisë dhe qasshmërisë deri të lokacioni turistik dhe rritjes të atraktivitetit të tij. Arritja e këtij qëllimi është paraparë që të realizohet përmes: Kënaqjes të nevojave dhe prioriteteve të segmenteve prioritare të tregut dhe vizitorëve përmes aktiviteteve në kuadër të lokacionit turistik; Përmirësimi i infrastrukturës turistike përmes qasshmërisë deri të lokacioni turistik për rekreacion dhe pushim të vizitorëve potencial dhe Promovimi i lokacionit turistik përmes shpërndarjes të informacioneve (të shtypura dhe elektronike).

Realizimi qëllimeve të parapara projektuese që pritet të rezultojë me keto rezultate:

- Rehabilitimi i rrugës lokale Diga e Mantovës – fshati Gabrovc në gjatësi prej 6.575 metra për të siguruar qasje të sigurtë deri të liqeni i Mantovës;
- Janë mapuar dhe shënuar 2 rrugë për këmbësorë. Një në lokalitetin "Çukata" me gjatësi prej 1.000 m dhe e rruga e dytë për këmbësorë respektivisht pedonalja "Vendbanimi liqenor dhe me diell i Mantovës" ("shtëpizave të Vllehëve" – liqeni i Mantovës) me gjatësi prej 2.000 m;
- Është siguruar atraktiviteti i lokalitetit "Shtëpizat e Vllehëve – Manastir Shën. Gjergji" përmes ndriçimit të lokalitetit;
- Është instaluar pajisja urbanë (tavolina dhe shporta për mbeturina);

2.2 Lokacioni i projektit

Rrugica lokale Diga e Mantovës – fshati Gabrovc

Rruga e rrugicës lokale Diga e Mantovës – fshati Gabrovc është lokalizuar në shpatet e që janë në drejtim jugpërendimor pranë bregut të djathtë të lumit të Llakavicës respektivisht hidroakumulimit të Mantovës. Rruga është përkufizuar me zgjedhjen e pikave fikse të përcaktuara në bazë të konfigurimit të tërrenit dhe bazat situacionale dhe njohja e tërrenit e kryer nga ana e projektuesit. Tërrenet në të cilët është tërhequr rruga janë kryesisht toka të braktisura me bonitet të ulët, pyje të rralla, dhe kullota.

Rruga e këmbësorëve (pedonalja) deri të Teskoveçka Çuka:

Rruga e këmbësorëve është ekzistuese. Fillon nga rruga lokale në afërsi të stacionazhit km 2+850 dhe vazhdon deri në majë të kodrës Teskoveçka Çuka

Rruga "Shtëpizat e Vllehëve – Manastiri Shën Gjergji":


Rruga e këmbësoreve është ekzistuese. Fillon nga lokaliteti shtëpizat e Vllehëve dhe lëviz pas bregut të akumulimit të Mantovës.

Ndriçimi i lokalitetit Shtëpizat e Vllehëve:


Është siguruar atraktiviteti i lokalitetit “Shtëpizat e Vllehëve – Manastiri Shën Gjergji” përmes ndriçimit të lokalitetit

Pajisja urbane:

Është paraparë vendosja e pajisjes urbane, tavolina dhe shporta për mbetje në afërsi të rrugës lokale në afërsi të stacionazhit km 3+300



Fotografia 1 Paraqitja satelitore e aktiviteteve të tërësishme projektuese (Burimi: Goggle Earth)



Fotografia 1 Paraqitja satelitore e rrugës lokale, rrugët për këmbësorë (me ngjyrë të verdhë) ndriçimi (ngjyrë të bardhë) dhe lokacioni i paraparë për vendosjen e pajisjes urbane (Burimi: Goggle Earth)

Lokacionet në fjalë, sipas të dhënave të Agjencisë për Kadastër të patundshmërisë të Republikës të Maqedonisë (www.katastar.gov.mk), përshijnë një numër më të madh të parcelave kadastrale të cilat bëjnë pjesë në kufijtë e Komunës të Konçes. Në vazhdim është dhënë paraqitja e parcelave kadastrale në të cilat do të realizohen aktivitetet projektuese:

Pronari aktual i rrugës “Diga e Mantovës – fshati Gabrevc” është komuna e Konçes.

Pronar i lokacioneve tjera ku janë paraparë intervenime është Republika e Maqedonisë. Drejtimi i rrugës “Çuka” (linja1) përfshin:

PK nr. 1620 dhe 1621 është shënuar në fletën e pronësisë nr.2 dhe nr.3, KK Vrashtica e Poshtme, pronë e Republikës të Maqedonisë.

Linja e rrugicës “Shtëpizat e vlllehëve – liqeni i Mantovës” (linja 2) përfshin:

PK nr. 936 e shënuar në fletën e pronësisë nr.16, KK Vrashtica e Poshtme pronë e Republikës të Maqedonisë

PK nr. 434 është shënuar në fletën e pronësisë nr.19, KK Vrashticë e Poshtme në Republikën e Maqedonisë.

PK nr. 218 është shënuar në fletën e pronësisë nr. 35, KK Vrashtica e Poshtme që është pronë e Republikës të Maqedonisë.

PK nr. 226 e shënuar në fletën e pronësisë nr.51, KK Vrashtica e Poshtme që është pronë e Republikës të Maqedonisë.

PK nr. 217 e shënuar në fletën e pronësisë nr 120, KK Vrashtica e Poshtme që është pronë e Republikës të Maqedonisë.

PK nr. 976, 977, 110, 933, 934, 225 dhe 220 e shënuar në fletën e pronësisë nr.17, KK Vrashtica e Poshtme që është pronë e Republikës të Maqedonisë

2.3 Përshkrimi teknik dhe teknologjik i aktiviteteve

Rrugica lokale Diga e Mantovës – fshati Gabrevc

Zgjidhja horizontale: Elementet horizontale – lakesa me të cilin është konstruktuar linja, përgjigjen për shpejtësinë $V = 40(30)$ km/h. Shpejtësia $V = 40$ km/h nënkupton zbatimin e $R_{\min} = 45m$ me $q = 7\%$ që në parim është respektuar.

Sanimi i segmenteve të dëmtuara planifikohet me zëvendësimin e shtresës ekzistuese të tamponit me shtresë të re të tamponit $d = 30cm$ nga guri i thërmuar me $CBR > 20\%$. Përveç asaj në vendet ku është planifikuar zëvendësimi i sipërfaqës ekzistuese të asfaltit parashihet largimi i tërësishëm i sipërfaqës ekzistuese të dëmtuar të asfaltit dhe zëvendësimi me shtresë të re të asfaltit me shtresë të njëjtë si parapraku $d = 7cm$ me asfalt BNHS-16. Pas sanimit të pjesëve të dëmtuara të rrugës, gjithë sipërfaqja e asfaltit spërkatet me emulzion të bitumenit mbi të cilën asfaltohet me një shtresë të asfaltit BNHS-16 në shtresë prej $dd = 5cm$.

Zgjidhja vertikale – niveluese në rrugën e paracaktuar me rrjedhën horizontale në linjën dhe pikat e zgjedhura fikse në të cilat është tërhequr linja respektivisht rrugica. Me këtë është kushtëzuar ngritja mestimike lëshimi i nivelatës duke ndjekur konfigurimin e terrenit përgjatë linjës respektivisht rrugës.

Kodrat e larta të nivelatës janë në kufijtë prej 453.00 në fillim deri në 476.00 në km 2+950. Në vazhdimësi nivelata lëshohet në 424.30 në fund të rrugës.

Nivelata është konstruktuar me drejtime dhe lakesa të cilat janë në përputhje me nivelin e rrugës dhe shpejtësinë projektuese. Pjerrtësia maksimale e paraparë në gjatësi është 10% kurse minimalja është 0.3%.

Karregjata me dredha është kryer me shpatë të tërthorta për $B = 40km/h$, kurse tek kthesat e jashtëzakonshme horizontale për $B = 30km/h$.

Zgjidhja e profilin të rrjedhës të lumit: Me vendpozitën e tij, kjo lidhje rrugore në perspektivë mund të kalojë në nivel të rrugës rajonale e cila është komentuar edhe në pjesën hyrëse të këtij raporti. Gjithsesi profili pengues është në rrugë si fazë e parë e këtij projekti.

- Karregjata me një drejtim (korsi) trafiku $1 \times 3.50 = 4.50m$

- Bankinat $2 \times 0.50 = 1.00m$

Kullimi: Kullimi është zgjidhur me shpatet e kryqëzuara dhe vetë strukturës të konstruksionit të karregjatës. Në këtë projekt është paraparë pastrimi i tërësishëm i kanaleve përgjatë rrugës me çrast të njëjtat do të mund të funksionojnë në mënyrë normale. Përveç asaj është paraparë kalimi respektivisht pasazhi nga dy profilet e tubave F1000 në stacionazhin 6+790.00 në tërësi me kokën hyrëse dhe dalëse.

Rruga për këmbësorë deri në Tëskovaçka Çuka:

Rruga për këmbësorë është ekzistuese. Fillon nga rrugica lokale përafërsisht nga stacionazha km 2+850 dhe vazhdon në lartësinë e Teskoveçka Çuka. Rruga është me gjatësi prej 1 km. Për të njëjtën është paraparë përafrimi dhe shënimi i rrugicës.

Rrugica "Shtëpizat e vllhëve – Manastiri Shen Gjergji":

Rruga për këmbësorë është ekzistuese. Fillon nga lokaliteti Shtëpizat e vllhëve dhe shtrihen pas bregut të akumulimit të Mantovës. Rrugica është me gjatësi prej 2 km. Për të njëjtën është paraparë përafrimi dhe shënimi i rrugicës.

Ndriçimi i lokalitetit Shtëpizat e Vllhëve:

Është siguruar atraktiviteti i lokalitetit "Shtëpizat e vllhëve" përmes ndriçimit të lokalitetit. Është paraparë lidhësi, instalimi dhe vendosja e fenerëve të rrugës.

Pajisja urbane:

Është paraparë furnizimi dhe montimi i 10 tavolinave dhe furnizimi dhe montimi i 20 shportave për mbeturina.

3. Korniza politike, ligjore dhe administrative

Procesi i vlerësimit të mjedisit jetësor shërben si kontribut primar në procesin e vendimeve nga ana e pushteteve maqedonase, të cilët duhet të aprovjnë projektin përpara se i njëjti të ndërtohet dhe të punojë, nga ana e Bankës Botërore e cila siguron mjetë financiare për këtë projekt.

Korniza ligjore nacionale

Procedura e vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin jetësor është përcaktuar në Ligjin për mjedisin jetësor – Gazeta Zyrtare nr. 53/05, 81/05 24/07, 159/08 dhe 83/09; 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 163/13, 42/14, 129/15 dhe 39/16 (Kreu XI / nënët 76-94) ku janë kërkesat e direktivave të BE-së për VNMJ (Direktiva 85/337/ EEZ e ndryshuar me Direktivat 97/11 / EZ, 2003/35 / EZ и 2009/31 / EZZ) janë transponuar.

Procedura fillon kur Investitori (Aplikuesi i projektit) i cili ka për qëllim të realizojë projektin dërgon Letër për qëllimet në formë të shkruar dhe elektronike deri të Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinorë (MMJPH – Drejtoria/Administrata për mjedisin jetësor), e cila është kompetente për të gjithë procedurën. Administrata për mjedisin jetësor ka për detyrë të jap informacion kthyes për kërkesën konkrete nëse duhet apo nuk duhet që të zhvillohet VNMJ dhe VSNMJ apo elaborate për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Procedura e skringut është faza në të cilën MMJPH vërteton nëse duhet të realizohet VNMJ dhe VSNMJ apo elaborat apo jo për projektin e caktuar. Për realizimin e projekteve që nuk janë në listën e projekteve për të cilat duhet të realizohet procedura për VNMJ (projekte të vogla), ka nevojë për përpunimin e Elaboratit për mbrojtjen e mjedisit jetësor – Raporti për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor i BB OP 4.0.1).

Gjatë etapës të kontrollit të Procedurës për vlerësim të ndikimit të mjedisit jetësor, në rast se vendoset se nuk ka nevojë për Procedurën për vlerësim të ndikimit në mjedisin jetësor, investitori duhet të përgatisë Raport për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor – Elaborat. Kjo procedurë është e detyrueshme për projektet e vogla (shembull: Rekonstruktimi i rrugëve lokale, ndërtimi i sistemeve të ujësjellësit, kanalizimi etj) të cilat shkaktojnë ndikim negativ afatshkurtër dhe të vogël mbi mjedisin jetësor.

Ekzistojnë dy Rregullore për përgatitjen e Raportit për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor – Elaborati për projektë të vogla:

- Rregullorja për listën e projektëve për të cilat duhet të përgatitet Raport për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor nga ana e investitorit dhe Raporti duhet të miratohet nga ana e Ministrisë të mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinorë (Gazeta Zyrtare nr.36/12);
- Rregullorja për të listuar projektet për të cilat duhet të përgatitet Raport për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor nga ana e investitorit dhe Raporti duhet të miratohet nga kryetari i komunës apo nga kryetari i Qytetit të Shkupit (Gazeta Zyrtare nr.32/12)

Përmbajtja e Raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor – Elaborati duhet të jetë në përputhje me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e Raportit dhe me procedurat për miratimin e Raportit për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.12/132).

Raporti për VNMJ – Elaborati përmban karakteristikat kryesore të aktiviteteve, ndikimet kryesore pozitive dhe negative mbi mjedisin jetësor. Programi i thjeshtë për mbrojtjen e mjedisit jetësor përbëhet nga masat për parandalimin, zbutjen dhe kompenzimin e ndikimeve negative mbi të gjithë elementet e mjedisit jetësor të cilat duhet të zhvillohen në përputhje me legjislacionin nacional dhe praktikat ndërkombëtare mbi mjedisin jetësor. Gjatë përgatitjes dhe miratimit të Raportit për VNMJ – Elaborati nuk ka nevojë për debat publik.

Lista e rregullativës dhe dokumentet për masat e propozuara për menaxhimin e mjedisit jetësor

1. Ligji për mbrojtjen e mjedisit jetësor ("Gazeta Zyrtare e RM-së " nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13,42/14, 44/15, 129/15 dhe 39/16);
2. Ligji për menaxhimin e mbeturinave ("Gazata Zyrtare e RM-së " nr. 68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 134/08, 82/09, 124/10, 09/11, 47/11, 51/11, 163/11, 123/12, 147/13, 163/13, 51/15, 146/15, 156/15, 39/16 dhe 63/16);
3. Ligji për mbrojtje nga zhurma në mjedisin jetësor ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 79/07, 124/10, 47/11 dhe 163/13);
4. Ligji për cilësinë e ajrit ambiental ("Gazeta Zyrtare e RM-së " nr. 67/04, 92/07, 35/10, 47/11, 59/12, 100/12, 4/13 dhe 10/15);
5. Ligji për mbrojtjen e natyrës ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.67/04, 14/06, 84/07, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13, 163/13, 41/14, 146/15, 39/16 dhe 63/16);
6. Ligji për menaxhimin me paketimin dhe mbeturinat nga paketimi ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 161/09, 17/11, 47/11, 136/11, 6/12, 39/12, 9/13 dhe 39/16);
7. Ligji për siguri dhe shëndet (Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.92/07, 136/11, 23/13 ,25/13 137/13, 164/13, 158/14, 15/15, 129/15 dhe 192/15)
8. Ligji për ujërat ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 87/08, 6/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/12, 23/13, 163/13, 180/14 dhe 146/15);
9. Ligji për ndërtim ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 59/11, 13/12, 144/12, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 44/15, 129/15 dhe 39/16)
10. Ligji për mbrojtje dhe siguri në vendin e punës ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 92/07, 136/11, 23/13 dhe 25/13)

11. Ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ("Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë" nr. 20/04, 71/04, 115/07, 18/11, 148/11, 23/13, 137/13, 164 / 13, 38/14, 44/14, 199/14, 104/15, 154/15, 192/15 dhe 39/16)

Sipas legjislacionit nacional, për aktivitetet e parapara me këtë nën-projekt është përgatitur elaborat për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Elaborati është aprovuar nga: Vendimi për miratimin e elaboratit për mbrojtjen e mjedisit jetësor për rehabilitimin e rrugës lokale, f.Vrashtica e Poshtme deri të f.Gabrevc, nga km 0 + 602,61 deri km 6 + 792,60, numri i arkivës 12-6 nga 07/11 / 2017, e lëshuar nga Komuna e Konçes. Vendimi është në Anëksin e këtij dokumenti.

Politika e Bankës Botërore për mbrojtjen e mjedisit jetësor

Politika për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe politikave sociale e Bankës Botërore konsiderohet si gurëthemel në mbështetjen e tyre për zvogëlimin e varfërisë të qëndrueshme. Qëllimi i këtyre politikave është që të ndalet dhe të zbutet dëmi i panëvojshëm i njerëzve dhe mjedisi i tyre jetësor në procesin e zhvillimit. Këto politika ofrojnë kahje për BB gjatë identifikimit të debitorëve, përgatitjes dhe realizimit të programeve dhe projekteve. OP 4.01 Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor (VNMJ) është një nga dhjetë politikat mbrojtëse ekologjike, sociale dhe juridike të BB. VNMJ shfrytëzohet në BB që të identifikohen, të shmangen dhe/ose të zbuten ndikimet potenciale negative mbi mjedisin jetësor që lidhen me punën e kreditimit. Qëllimi i VNMJ është që të përmirësohet procesi i vendimmarrjes, të sigurohet që opsionet e projektit të cilat shqyrtohen të jenë të shëndetshme dhe të qëndrueshme dhe se palët e përfshira potenciale konsultohen në mënyrën përkatëse. Politika për vlerësimin e mjedisit jetësor nga Banka Botërore dhe procesimi i rekomanduar janë shënuar në **Politikat operative (PO)/Procedura e bankës (PB) 4.01: Vlerësimi i mjedisit jetësor.**

Kjo politikë konsiderohet si politika "ombrellë" e politikave mbrojtëse të BB për mjedisin jetësor. Gjatë përgatitjes të këtij dokumentacioni do të shfrytëzohen politikat vijuese:

- Politika operative për mjedisin jetësor (PO 4.01, 1999, e rishikuar në prill, viti 2013);
- Politika operative për resurset kulturore fizike (PO 4.11, 2006);
- Politika operative për vendbanimet natyrore (PO 4.04, 2001), si dhe

Kerkesat e BB për publikimet e informacioneve të përshkruara detajisht në politikën për qasje deri te informacionet, hera e fundit është rishikuar në korrik 2015.

PO/PB i Bankës Botërore për vendbanimet natyrore kanë për qëllim që të mundësohet që projektet infrastrukturore dhe projektet tjera zhvillimore të BB ta marrin parasysh për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike. Politika rreptësisht i kufizon projektet ku mund të demtohen vendbanimet natyrore, si toka dhe uji ku janë të pranishme lloje autoktonë bimore dhe shtazore. Me saktësisht, politika e BB ndalon mbështetjen e projekteve të cilat do të sjellin deri të humbja e konsiderueshme apo degradimi i vendbanimeve kritike natyrore, të cilat janë:

- Të mbrojtura me ligj;

- Zyrtarisht të propozuara për mbrojtje;
- Të pambrojtura, por të njohura si vlerë e lartë konzervuese.

Në përputhje me politiken e BB për qasje deri të informacionet, konsultat publike dhe shpalosja duhet të ndjekin procedurat konkrete: planet për menaxhimin e mjedisit jetësor dhe çështjet sociale do të jenë në dispozicion në fomën publike në ueb faqen e LRCP PIU/ Kabineti i zëvendës kryeministrit të Qeverisë të Republikës të Maqedonisë, Komunës Konçe dhe Agjencisë për promovimin dhe mbështetjen e ueb faqeve turistike dhe do të shërbejë si dokument themelor për miratim.

3.1 Konsulta publike për projektin reth Planit për menaxhimin me mjedisin jetësor

Është përgatitur **plani për menaxhimin me mjedisin jetësor dhe aspektet sociale (PNMJ)** për këtë projekt do të jenë pjesë e dokumentacionit tenderues dhe marreveshja me realizuesin respektivisht kontraktorin (se bashku me paralogarinë/preventivin) që do të jenë të detyrueshme për realizimin e masave të parapara sipas Planit për zbutje dhe vëzhgim. Realizimi i PNMJ është i detyrueshem për realizuesin.

Sipas PNMJ – (Korniza për menaxhimin e mjedisit jetësor), ky PNMJ duhet të jetë objekt i konsultimeve publike para se të aprovohet përfundimisht nën-granti. Pasi të miratohet draft verzioni i PNMJ nga ana e (NjRP – Njësia për realizimin e projekteve) profesionisti për mjedisin jetësor dhe specialisti për mjedisin jetësor i BB, i njëjti do të publikohet në ueb faqën e (NjRP – Njësia për realizimin e projektit) (Kabineti i zëvendës kryeministrit për çështje ekonomike në Qeverinë e RM-së, Agjencia për promovimin dhe mbështetjen e turizmit dhe ueb faqja e komunës të përfshirë (Komuna e Konçes) do të informojë dhe do të ftojë palët kryesore të përfshira të projektit, duke përfshirë edhe OJQ-të lokale, qytetet e përbashkëta dhe komuna të prekura në menyrë të drejtëpërdrejtë dhe me mjete përkatëse. Komentet e dërguara do të përfshihen në Raportin nga shqyrtimi publik që do të jetë pjesë e verzionit final të PNMJ. Në këtë menyrë të gjithë komentet nga publiku do të jenë të disponueshme për kandidatët dhe do të marrin të gjithë komentet relevante dhe do të përfshijnë përgjigjet dhe vërejtjet në PNMJ përfundimtare.

PNMJ duhet të kalojë në konsultim publike në gjuhën angleze, maqedonase dhe shqipe. Realizimi i Planit të menaxhimit me mjedisin jetësor dhe aspektet sociale do të mundësojë ndërmarrjen në kohë të masave të propozuara dhe do të kontribuojë drejtë realizimit të aktiviteteve projektuese pa ndikime të konsiderueshme mbi mjedisin jetësor.

Aplikanti (Komuna e Konçes), në menyrë proaktive do të informojë dhe do të ftojë aktorët më të medhenj të projektit, duke përfshirë edhe OJQ-të lokale, komunitetet e përfshira dhe komunat në menyrë të drejtëpërdrejtë dhe përkatëse. Komentet e dërguara do të përfshihen në Raportin për dëgjuesin publike, që do të jetë pjesë e verzionit final të VNMJ. Në këtë menyrë të gjithë komentet publike do të jenë të disponueshme për aplikantët dhe ato do të marrin të gjithë komentet relevante dhe do të përfshijnë përgjigjet dhe vërejtjet në VNMJ përfundimtare.

4. Të dhënat kryesore

Aktivitetet e parapara të nën-projektit "Përmirësimi i qasjes dhe atraktivitetit për "Vendbanimin liqenor dhe diellor të Mantovës dhe rethinës" përfshihen në kuader të komunës të Konçes.

Komuna e Konçes

Komuna e Konçes është komunë rurale në Maqedoninë Juglindore. Qendra e komunës është fshati Konçe dhe në kuadër të Komunës Konçe janë edhe 13 vendbanime të tjera. Komuna gjendet nën shpatët në malin Serta, në reth 150 kilometra distancë nga kryeqyteti i Maqedonisë – Shkupi. Komuna e Konçes ka gjithsej popullsi prej 3,690 banorë (2002) dhe sipërfaqe të përgjithshme prej 233,05 kilometra katrorë. Popullsia e Komunës të Konçes është kryesisht maqedonase, por ka edhe pakicë të vogël turke.

Sipas Ligjit për vetëqeverisjen lokale, komuna e Konçes është e përkufizuar si njësi e vetëqeverisjes lokale, e themeluar në vitin 1996 me Ligjin për organizim territorial. Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, përkufizohen kompetencat e njësive të vetqeverisjes lokale. Komuna është qendër shërbimi për qytetarët nga fusha e urbanizmit, veprimtarive komunale, përcaktimi i tatimeve dhe të hyrave, me kompetenca në arsim, mbrojtje të mjedisit jetësor, kulturë, sport, zhvillim lokal ekonomik etj. Komuna e Konçes është e organizuar në njësi organizative – sektorë.

1. Sektori për urbanizëm, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe zhvillimit ekonomik lokal,
2. Sektori për financa dhe buxhet,
3. Sektori për punë normative juridike,
4. Sektori për punë inspektuese.

Shërbimet komunale në territorin e komunës Konçe i jep ndermarrja publike komunale NPK Lakavica Konçe në pjesen e: ujësjellësit, grumbullimit dhe kullimit, pastrimit publik, grumbullimi dhe depozitimi i mbeturinave komunale, mirëmbajtja e ndriçimit të rrugës, rrugët dhe rrugicat lokale etj. Komuna e Konçes në pjesën e mjedisit jetësor ka kapacitet që të menaxhojë përmes sektorit për urbanizëm, mbrojtjes të mjedisit jetësor dhe përmes sektorit inspektues me inspektorin e autorizuar komunal dhe inspektorit më të ri për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Komuna e Konçes është komunë rurale me seli në lagjen Konçe. Organet e komunës janë: Kryetari dhe këshilli i komunës Konçe. Kryetari si organ i komunës përfaqësohet nga komuna në përputhje me kompetencat e tij ligjore. Këshilli i komunës përbehet nga nëntë anëtarë (këshilltarë). Kompetencat e këshillit të komunës janë të përkufizuara në Ligjin për vetqeverisje lokale dhe në aktet tjera nënligjore. Në administratën komunale ka gjithsej 15 të punësuar, prej të cilëve 8 janë administratorë shtetërorë. Ndermarrja publike ka 11 të punësuar.

Komuna është pjese e rajonit të Radovishit, kurse në aspekt statistikor është pjesë e rajonit Juglindor. Komuna ka gjithsej 3,690 banorë me dendësi të popullsisë prej 15,17 banorë në kilometër katrorë dhe sipërfaqe të përgjithshme prej 233,05 kilometra katrorë.

Në kuader të Komunës Konçe bejnë pjese 14 fshatra, dhe atë: Gabrevci, Garvan, Lipoviçi i sipërm, Dedino, Vrashtica e Poshtme, Lipoviçi i Poshtëm, Zagorc, Konçe, Lubnica, Ngrenovci, Rakitec dhe Skorusha. Komuna e Konçes kufizohet me Komunën e Shtipit, Komunën e Negotinës, Komunën e Demir Kapisë, Komunën e Vallandovës, Komunën e Strumicës, Komunën e Vasilevës dhe Komunën e Radovishit.



Fotografia 2 Komuna e Konçes në Republikën e Maqedonisë dhe vendbanimet në Komunën e Konçes

Karakteristikat e relievit

Zona më e gjërë në komunë është zona kodrinore. Pyllëzimi dhe vegjetacioni në këtë zonë janë shumë të rralla. Ka pyllëzim me drunj të ulët, lis i rrëgjuar, drunjë, shkozë dhe bimë tjera me të ulëta pyjore.

Morfologjia e hapësirës është me një reliev të valëzuar në forme të butë, me prani të kupave vullkanike dhe kraterëve të degraduara, si forma karakteristike për vullkanizmin e Tercierit, duke i dhënë hapësirës shenja specifike të peizazhit. Shpatët janë të prera me rrudha të shumta erozive dhe pjesë. Mbi zhvillimin e relievit më shumë ndikojnë lëvizjet orogjene gjatë kohës të orogjenezës Alpike, e cila ka filluar në fundin e Paleogjenit. Në atë kohë janë dhënë karakteristikat themelore të relievit të ndërtuara me proceset tektonike. Duhet të tregohet në faktin se lëvizjet e vjetra tektonike kanë ndikuar në relievin bashkëkohor përmes strukturave të ndryshme, përmes pozitës të shkëmbinjëve, të cilët i kanë dhënë kahje erozionit të sotëm dhe krijimit të relievit. Me tutje, lëvizjet me të reja tektonike gjatë diliviumit kanë kushtëzuar rrjetin e

linjave çarëse. Si rezultat i proceseve të shpatëve, vjen deri të krijimi i lymit deluvial-proluvial, honët etj e shprehur në pjesët e terrenit pa vegjetacion si rezultat i dhënies të kahjes të ujërave sipërfaqësore nga shirat në kahjet e caktuara nga relievi dhe ndërtimi gjeologjik i terrenit. Si rezultat i erozionit lumor-fluvial, vjen deri te krijimi i shtresave respektivisht fundërrinave të gjëra në brezaret aluviale që nuk janë të lidhura.

Karakteristikat hidrogeologjike

Karakteristikat hidrogeologjike në zonën e pellgut në lumin Kriva Llakavicë janë me rëndësi të madhe për regjimin hidrologjik. Nga hulumtimet e deritashme hidrogeologjike të kryera në zonën më të gjërë dhe më në gjërësi, është përgatitur përkthimi hidrogeologjik i hartës hidrogeologjike. Harta hidrogeologjike e RM-së, bazohet në strukturën litologjike – tektonike të terrenit, struktura me pore dhe cilesitë filtruese të shkëmbinjve. Duke patur parasysh kriteret e rajonit të Dojranit, janë ndarë dy lloje kryesore të mjediseve hidrologjike:

- Të përshkueshme nga uji të cilat janë të ndara në tre grupe: sedimente kuartale që nuk janë të lidhura, të gjelbërta të forta dhe shkëmbinj të ngjajshëm, dhe shkëmbinj karbonatik,
- Shkëmbinj të papërshkueshem nga uji që janë më të shpërndarë: lymi deluvial, granit, dhe shisti argjilor sericit-kloritit, konglomeratet e eocenit dhe të tjera

Shtretërit e ujërave nëntokësore – akuiferët. Nga aspekti i vlerave hidrogeologjike dhe teknoekonomike të rajonit të Dojranit janë ndarë 4 lloje të akuiferëve me rëndësi praktike dhe tematike, dhe ato janë: akuiferë në sedimentet liqenore, akuiferë në sedimentët proluviale, akuiferët në mermeret dhe zonat e ujërave gjeotermale.

Karakteristikat klimatike

Rajoni është nën ndikim të klimës të moderuar kontinentale me elemente të caktuara klimatike të cilat variojnë ndërmjet klimës të ndryshueshme mesdhetare në fushë dhe klima malore në male. Temperaturat mesatare vjetore në pjesën e rrafshnaltës të cilat variojnë nga 12.5 deri në 13.0°C, ndërsa në pjesët më të larta në masivet malore deri në 7.5°C. Muajt më të ngrohtë janë korriku dhe gushti, me temperaturë mesatare prej 23°C, ndërsa muaji më i ftohtë është janari me 1.2°C. Shirat mesatare vjetore janë 563 mm, me variacione të mëdha nga viti në vit. Ka dallime ndërmjet rajoneve malore dhe të rrafshnaltave. Sa i përket shumës vjetore të orëve diellore, rajoni ka 2326 orë diellore në vjet, që do të thotë 6.4 orë në ditë.

Karakteristikat hidrografike

"Mantova" është akumulim artificial i cili ndodhet në shtratin e lumit "Kriva Llakavica". Akumulimi përfshin sipërfaqë prej 350 ha. (494 ha) me thellësi të ndryshme e cila varion nga 1m deri në 40m. (20 m). Kuota maksimale është 406,5 l.m me vëllim total prej 47,5 milion m³ ujë

dhe vëllim të shfrytëzuar të akumulimit prej 40 milion m³ ujë. Akumulimi "Mantova" ka formë të zgjatur dhe shtrihet në drejtim lindje – perëndim.

Nga veriu kufizohet me zonën e fshatit Vrashtica e Poshtme, nga lindja me zonën e fshatit Gabrevc, në jug me zonën e fshatit Radesh i Poshtëm, ndersa nga perëndimi me zonën e fshatit Garvan, prej ku edhe gjendet penda e digës.

Si burime themelore të degëve të ujit të lumenjve Llakavica, Koneçka dhe Gabreshka. Gjithashtu, si zonë më e madhe e pellgut në digë derdhen me shume përrenjë siç janë: Zgorečki, Skorushki, dhe Borovski.

Akumulimi "Mantova" karakterizohet me prodhim të përditshëm të lartë organik sepse shtrihet në sipërfaqet e përpunuara me parë dhe në livadhe, si dhe në pyje me kultura të shkurreve dhe numer jo i madh i kulturave më të larta pyjore.

Sistemi i ujitjes përbëhet nga dy kanale magjistrale: kanali i majtë magjstral me gjatësi prej 29762 m, me fuqi të përshkueshme prej 24.3 m³ • sek⁻¹; dhe kanali i djathtë magjstral me gjatësi prej 19220 m, me fuqi përshkuese prej 30,8 m³ • sek⁻¹. Në nivel vjetor për nevojat e bujqësisë shpenzohen nga 8 deri në 10 milion m³ • sek⁻¹ ujë, ndërsa për nevojat e minierës Buçim shpenzohen nga 1 deri në 5 milion m³ • sek⁻¹ ujë. Thellësia maksimale e akumulimit është 40 m.

Shumëllojshmëria biologjike dhe zonat e mbrojtura

Habitatet pyjore dhe ato me kaçuba në zonën e hulumtuar në përgjithësi janë të prezantuara me pyje lisi respektivisht dushku me shkallë të ndryshme të degradimit. Pothuajse e gjithë fusha ndodhet në rripin tipik me pyje lisi-shkozë. Ky është tip dominant i vegjetacionit i cili i rregullon karakteristikat e rajoneve kodrinore dhe paraqet rripin më të ulet të vegjetacionit.

Pyjet e lisit dhe shkozës (Querco-Carpinëtum orientalis): Pyjet e lisit dhe shkozës bëjnë pjesë në bashkësinë e pyjeve të lisit Querco-Carpinetum orientalis macedonicum Rud. 39 apud Ht. 1946.

Pyjet bungëbutë (Quercus pubescens) dhe shkoza (e bardhë) (Carpinus orientalis) janë indikatorët kryesorë në këto pyje. Krahastyre, në këtë komunitet gjenden dhe lloje të tjera të drurit sic janë: Fraxinus ornus, Acer monspessulanum, Colutea arborescens, Coronilla emeroides, Rhamnus rhodopaea, kurse nga barishtet karakteristike janë Cyclamen neapolitanum dhe Carex halleriana. Kjo bashkësi zhvillohet pothuajse në të gjithë vendin (lindor, juglindor, jugor, jugperëndimor dhe perëndimor) deri në 600 m lartësi mbidetare, por në disa lokalitete, në kushte të tokave të thella dhe të thata gurore ka klimë të ngrohtë dhe me lartësi mbidetare deri në 1000 m. Në Maqedoni kryesisht është shpërndarë në pjesën qendrore dhe lindore.

Sipas legjislacionit nacional, në afërsi të lokacionit të projektit, nuk ka zonë të mbrojtur apo fusha të përcaktuar për mbrojtje. Gjithashtu, gjatë përgatitjes të dokumentacionit projektues, nuk janë zbuluar lloje të ralla apo të rrezikuara, bimë apo shtazë për sipërfaqen projektuese apo në rethinën e tij.

Demografia

Si pjese e Komunës të Konçes janë 11 vendbanime prej të cilave 6 janë aktive, 3 janë me numër shumë të vogël të banorëve, ndërsa 2 fshatra nuk kanë aspak banorë. Numri i përgjithshëm i banorëve në komunë është 3.546 banorë. Popullsia merret kryesisht me bujqësi. Sipas të dhënave bashkarisht me vitin 2011, numri i përgjithshëm i banorëve në Komunën e Konçes në vitin 2011 është rritur për 6,5% në raport me numrin e përgjithshëm të nxënësve në vitin 2007. Konçe është komuna e dytë pas rritjes të numrit të tërësishëm të nxënësve. Sipas regjistrimit nga viti 2002, grupi me i madh etnik ishin maqedonasit, por në komunë jeton edhe popullsi turke. Me përqindje, grupet entike janë të përfaqësuara kështu:

Grupi etnik	Numri i banorëve
Maqedonas	3009
Turq	521
Sërb	3
Të tjerë	3

Qarkullimi

Në komunën e Konçes, rrjeti lokal rrugor është në gjendje shume të mirë, ndersa për rrugët në vendbanime nuk mund të thuhet një gjë e tille. Në vendbanimin Dedino, Lipoviqi Gavrevci, vetëm rrugët të cilat janë edhe rrugë lokale për lidhjen me vendbanime tjera janë asfaltuar ndersa rrugët gjatë vendbanimeve janë tokësore, të trasuara, në disa seksione është vendosur tampon por asnjë nuk është e asfaltuar. Nëse merret parasysh se popullsia merret me bujqësi dhe posedon numër të madh të mekanizimit bujqësor, automjete, furgona dhe kamiona për transport atëherë është e dukshme edhe nevoja për ndërtim të rrugëve në vendbanime për lëvizje më të lehtë dhe më të sigurtë të tyre.

Infrastruktura komunale

Infrastruktura komunale në komunën e Konçes nuk është në nivelin e duhur. Ekzistojnë probleme edhe në furnizimin me ujë dhe në rrjetin kanalizues të kullimit. Pjesë e lagjeve më të vogla të fshatrave nuk disponojnë me rrjetin e ujësjellësit, kurse me ujë të pijshem dhe me nevoja tjera furnizohen nga çezmat lokale dhe nga burimet.

Rrjeti i kanalizimit gjithashtu nuk është në nivelin e duhur. Pjesa më e madhe nga vendbanimet nuk kanë rrjet të kanalizimit dhe problemi me ujërrat e zeza (fekalet) zgjidhet në menyrë individuale me gropat septike. Megjithatë, probleme ka edhe në vendbanimet që kanë ndërtuar rrjet të kanalizimit, ku edhe krahas ndërtimit të rrjeteve të kanalizimit, ekzistojnë amvisëri, të cilat nuk janë të lidhura më me to. Nuk ka sistem të ujësjellësit në fshatrat Vrashtice e Sipërme dhe e Poshtme, as në vendbanimin për fundjavë në lagjen e Mantovës.

Gjendja ekonomike

Ish qëndra episkopale mesjetare Konçe sot është komunë tipike rurale ku bujqësia, blegtorja, ujësjellësi dhe pylltaria ishin dhe do të jenë të përfshira në mënyrë direkte në zhvillimin e komunës Konçe me theks të veçantë në prodhimin e duhanit të cilësisë të lartë të llojit *Jaka* nga reth 1.000.000 kilogram nga prodhuesit e komunës tonë e cila paraqet 5% nga prodhimi i tërësishëm i duhanit në R. e Maqedonisë.

Në vendbanimet e komunës janë regjistruar vetëm objekte të vogla të tregtisë (dyqane) transport për rrugën e linjës lokale dhe kapacitet i vogël tregtar për riblerje dhe përpunim të qumështit.

Krahas duhanit, komuna Konçe me resurse të mëdha dhe potenciale për prodhim të ushqimit të shëndoshë disponon me pasuri të madhe pyjore dhe ujore. Për zhvillimin e industrisë të drurit, si dhe bletarisë, dhe sidomos gjuetisë dhe peshkimit, duke pas parasysh liqenet e Mantovës, Konçe 1 dhe Konçe 2 dhe pasuria e kafshëve të egra në malin e Koneçkës si një nga zonat më të pasura të gjuetisë në Republikën e Maqedonisë.

Kultura dhe sporti

Në kuadër të Komunës të Konçes ekziston KF Konçe. Më tutje, në komunë mbahen gara tradicionale në futboll të vogël gjatë kohës të pushimit në komunë, në 12 korrik. Gjithashtu, në komunë ekziston edhe klubi i futbollit të grave "kontaktet sportive". Nga jeta kulturore, në Komunën e Konçes ekzistojnë keto shoqata kulturore FA "Cvetovi" nga Dedina, SHKA "Karaxhaoglan", nga Konçe dhe SHKA "Zëri Maqedonas" nga Gabrevci.

Kisha Shën Stefan është tempull maqedonas mesjetar kishtar krishterë ortodoks i cili ndodhet në fshatin Konçe. Kisha ndodhet në pjesën perëndimore të fshatit, në afërsi të drejtëpërdrejtë në shkollën Goce Dellçev. Është ndërtuar në kohën mesjetare, më saktësisht në vitin 1366, në shekullin XIV. Në të kaluarën kisha ishte manastir me murg dhe ka mbajtur emrin Shën Bogorodica, me të cilën njihet edhe sot në popullsi. Ky emër do të lidhet me ikonën e çuditshme të Shën Bogorodicës e cila është paraqitur në zonën e kishës në Gjevgjeli.

Nuk ekzistojnë resurse kulturore fizike të cilat do të përfshihen nga nën-projekti: aktivitetet nuk realizohen në apo në afërsi të objekteve apo zonave të mbrojtura arkeologjike.

5. Ndikimi mbi mjedisin jetësor

Realizimi i aktiviteteve të parapara të nën-projektit "Përmirësimi i qasjes dhe atraktivitetit në vendbanimin liqenor dhe me diell të Mantovës dhe rethinës" do të shkaktojë ndikime të caktuara mbi mjedisin jetësor.

Përgatitja e këtij Plani është me qëllim që të lokalizohet dhe të përcaktohet ekzistimi i efekteve të dëmshme mbi mjedisin jetësor si rezultat i aktiviteteve projektuese të cilat do të realizohen gjatë realizimit të aktiviteteve të planifikuara projektuese.

Ndikimet mbi mjedisin jetësor të këtij lloji të aktiviteteve projektuese kategorizohen në dy lloje kryesore të aktiviteteve:

- Faza e rekonstruktimit
- Faza e shfrytëzimit

5.1 Emetimet

Në fazën ndërtimit (rregullimi i lokacionit turistik) priten keto emetime:

- Emetimi i shkurtër i pluhurit nga aktivitetet ndërtuese;
- Gazrat e shkarkimit nga mekanizimi ndërtues;
- Mbetja komunale, nga ndërtimi dhe nga gërmimi
- Zhurma nga mekanizimi transportues.

Në fazën operative priten edhe këto emetime:

- Gazra shkarkues nga burimet mobile të ndotjes (automjetet);
- Zhurma;
- Mbeturina komunale.

5.1.1 Emetimet në ajër

Ndotja e ajrit është shkaktuar nga emetimet e substancave ndotëse nga burimet mobile dhe statike, gjithashtu, nga ana e emetimeve të materieve biokimike të gjeneruara në procesin e djegjes të karburantit. Të dhënat në lidhje me shpërndarjen e materieve ndotëse në mjedisin jetësor dhe ndryshimet në përqëndrimin e tyre gjatë kohës, si dhe ndikimi i cilësisë të ajrit mbi format jetësore, janë gjithashtu indikatorë të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të ndikimit mbi cilësinë e mjedisit jetësor.

Faza e rekonstruktimit

Gjatë fazës të realizimit të aktiviteteve të parapara projektuese të nën-projektit "Vendbanimi liqenor dhe me diell të Mantovës dhe rethinës", në ajër do të paraqiten:

- Emetime të shkurtra të pluhurit gjatë realizimit të aktiviteteve ndërtuese;
- Emetime të gazrave shkarkues nga mekanizmi ndërtues.

Pluhuri i gjeneruar nga ana e intervenimeve mekanike për mekanizmin transportues dhe djegjes të makinave për karburant, gjatë kohës të punëve ndërtimore, ndikon në mjedisin jetësor të afërt dhe të largët në varësi nga madhësia e grimcave (diametri aerodinamik) dhe kushtet meteorologjike gjatë kohës të aktiviteteve, para se gjithash për shkak të shpejtësisë të erës (të cilat ndikojnë në shpërndarjen e tyre – bartje). Ndikimi i emetimeve të shkurta të pluhurit të gjeneruara gjatë kohës të fazës ndërtimore do të përforcohet së bashku me emetimet nga mekanizmi ndërtimor.

Emetimet e gazrave që shkarkohen në ajër do të gjenerohen nga makinat ndërtimore.

Substancat më të shpeshta ndotëse të krijuara nga gazrat shkarkuese janë SO₂, NO_x, CO, PM₁₀, karbohidratet e padjegura, sulfuri, plumbi, benzeni dhe hidrokarburet aromatike të cilat kontribuojnë për prodhimin dytësor të ozonit dhe të gjithë ata janë të pranishme si kërcënim i drejtëpërdrejtë apo i tërthortë për shëndetin e njerëzve dhe mjedisit jetësor.

Lloji dhe sasia e gazrave shkarkuese do të varet para së gjithash nga lloji i karburantit, gjendja e automjeteve, frekuenca e lëvizjes dhe kohëzgjatja e aktiviteteve të tyre.

Megjithatë, cilësia e karburantit në Maqedoni i ndjek standardet europiane dhe i njëjti kontrollohet nga ana e laboratoreve të akredituara. Kështu, mund të përfundojmë se burimet mobile nuk paraqesin kërcënim për cilësinë e ajrit.

Gjatë këtyre aktiviteteve ndërtuese, pranuesit më të ndjeshëm të cilët do të ekspozohen në emetime në ajër do të jenë të punësuarit, lagja në afërsi si dhe shumëllojshmëria biologjike në afërsi të linjave ku do të instalohet pajisja e adrenalines. Ndikimi mbi cilësinë e ajrit mund të vlerësohet si afatshkurtër, lokal, i tërthortë, i pakthyeshem, i shpejtë, me intenzitet të ulët të ndikimit mbi mjedisin jetësor.

Faza operative

Në fazën operative do të ketë ndikime mbi ajrin në kohën që do të realizohet qarkullimi në seksionin në fjalë, të shprehur përmes emetimit të gazrave shkarkues nga djegja e karburantëve në motoret me djegje të brendshme. Është e njohur se nga 1 litër benzin fitohet rreth 10 m² gazra të dëmshme të cilat ndikojnë në mënyre negative mbi organizmin njerëzor.

Ndotja e ajrit nga automjetet rrjedh nga disa vrima, nga të cilat pjesa kryesore, 95-99 % i takon gazrave që shkarkohen, ndërsa pjesa tjetër rrjedh nga karteri, karburatori dhe rezervuari i karburantit. Vetëm në gazrat shkarkuese të motoreve me djegje të brendshme gjenden rreth 280 substanca ndotëse. Shpërndarja e llojit të emetimeve në varësi nga kushtet në të cilat realizohet

qarkullimi (mjedisi urban apo autostrada), sipas testimeve të bëra në BE është paraqitur kjo tabelë:

Tabela 1 Shpërndarja e emetimeve nga automjetet motorike në varësi nga kushtet e qarkullimit (%)

Substancat ndotëse	Mjedisi urban	Autostrada
Monoksidi i karbonit	54	24
Oksidet e azotit	24	51
Karbohidratet	60	21
Dioksid sulfuri	31	46
Grimcat e forta	17	59
Aldehidet	51	29

Në fazen operative, pas ndërtimit të rrugës lokale do të rritet sasia e gazrave shkarkuese të emetuara, por kjo sasi nuk pritet që të ndryshojë në menyrë drastike cilësinë e ajrit atmosferik.

5.1.2 Ndotja e ujit

Faza e rekonstruktimit

Ndotja e ujërave mund të jetë fizike, kimike dhe biologjike. Ndotja fizike manifestohet përmes pjesëmarrjes të grimcave të forta nga mbeturina në tokë dhe në rërë të cilat rrjedhin nga aktivitetet ndërtuese. Ndotja fizike nga materiet e lëngshme është shkaktuar nga prania e yndyrave dhe vajrave. Nga të njëjtat mund të shkaktohet një film i cili do të ndalojë furnizimin me oksigjen në rrjedhën e lumit me çrast do të pengohet zhvillimi normal i florës dhe faunës akuatike.

Ndotja kimike shkaktohet si rezultat i shpërbërjes të ndotësve të pranishëm në ajër. Këto ndotës mund të rezultojnë nga gazrat që shkarkohen nga mekanizmi ndërtimor, emetimet nga komponentat ndotëse nga kapacitetet industriale dhe përpunuese, shpërbërja e komponentave nga toka përreth, nga përdorimi i mjeteve agrokimike dhe pesticideve, si dhe nga mbeturinat shtazore dhe bimore. Ndotja kimike mund të manifestohet në të gjithë variantat nga ajo me bazë të fortë deri te mjedisi me acid të fortë.

Ndotjet biologjike janë pasojë e shkatërrimit të materieve organike të cilat shërbejnë si ushqim për mikroorganizma të ndryshme. Ata mund të jenë rezultat nga sasi të jo të larguara të mbeturinave biodegraduese nga faza përgatitore.

Lokacionet e parapara për qëndrim të punëtorëve dhe për mirëmbajtjen dhe pastrimin e mekanizmit janë ndotësit potencial, përmes ujërave të zeza fekale, mbeturinat e forta dhe mirëmbajtja jo e duhur dhe pastrimi i mekanizmit.

Ndotja e ujërave nëntokësore dhe tokës mund të ndodh në raste të aksidenteve, siç është derdhja e karburantëve, vajrave, emulzionit të bitumenit etj. Furnizimi më i afërt me ujë në afërsi të lokacionit është akumulimi i Mantovës (afërsisht 200 m).

Aktivitetet ndërtuese mund të shkaktojnë ndotje të shprehur përmes futjes të mbeturinave ndërtimore nga betoni apo nga materialet tjera ndërtuese. Intenziteti i ndikimeve potenciale do

të varet nga karakteristikat fizike të lokacionit si dhe nga përbërja e substancave ndotëse potenciale.

Ndikimet e mundshme të ndotjes të përmendura me sipër do të priteshin gjatë rehabilitimit të rrugës lokale ekzistuese.

Faza operative

Në fazën operative, burimet e emetimeve në ujëra, në përgjithësi do të jenë të njëjta si dhe deri tani (në rast të aksidenteve, respektivisht derdhjes të karburanteve dhe vajrave).

5.2 Krijimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Me menaxhimin përkatës të mbeturinave të krijuara në përputhje me standardet e përgjithshme botërore të pranura do të zvogelohet ndikimi i mbeturinave në mjedisin jetësor.

Gjendja e përgjithshme në menaxhimin me mbeturinat mund të vlerësohet si pjesërisht e kënaqshme, sepse ajo nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në direktivat Europiane për menaxhimin me mbeturinat, para së gjithash në lidhje me grumbullimin e mbeturinave, mungesa e sistemit të integruar për menaxhimin me mbeturinat dhe gjendja e deponive komunale, dhe paraqitja e një numri të madh të deponive kundërligjore.

Mbeturinat e gjeneruara në territorin e Komunës të Konçes gjenerohen në deponinë "Konçe", dhe janë përgjegjësi e Ndërmarrjes publike për veprimtari komunale "Llakavica" Konçe.

Fazat e rekonstruktimit

Gjatë aktiviteteve të nën-projektit "Përmirësimi i qasjes dhe atraktivitetit të "Vendbanimit liqenor dhe me diell të Mantovës dhe rethinës" do të gjenerohen mbeturina komunale nga punëtorët, mbeturina ndërtuese nga aktivitetet ndërtuese, mbeturina nga gjermimi (material toke) dhe është e mundshme paraqitja e mbeturinave bimore në aktivitetet përgatitëse.

Shkaktarët e mbeturinave janë të detyruar të shmangin shkaktimin e mbeturinave dhe të zvogelojnë ndikimet e dëmshme të mbeturinave mbi mjedisin jetësor, jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Për menaxhimin e drejtë me mbeturinat, mbeturinat e prodhuara nga ana e punëtorëve, dhe mbeturinat inerte të cilat nuk do të shfrytëzohen, duhet të depozitohen në deponi ligjore. Realizuesi duhet të lidh marrëveshje për mbeturinat komunale me ndërmarrjen lokale komunale për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.

Në këtë fazë nuk pritet gjenerimi i mbeturinave të dëmshme, por në rast të gjenerimit të këtij lloji të mbeturinave, është e nevojshme që i njëjti të grumbullohet dhe të transportohet nga ana e kompanisë që është specializuar për menaxhim të llojit konkret të mbeturinave të dëmshme. Lokacionet për depozitim do të zgjidhen dhe miratohen nga ana e Komunës dhe do të licensohen në përputhje me legjislacionin nacional.

Llojet e mbeturinave të cilat shkaktohen gjatë aktiviteteve ndërtimore të rehabilitimit të seksionit, faza operative si dhe menyra e trajtimit të tyre është dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 2 Llojet e mbeturinave dhe sasi të

Faza	Numri	Mbeturinat e shaktuara	Numri nga lista me lloje të mbeturinave (Gazeta Zyrtare nr. 100/2005)	Sasia vjetore e prodhimit të mbeturinave (ton/L)	Mënyra e menaxhimit të mbeturinave (përpunimi, magazinimi, transporti, të disponuarit me to)	Përsoni juridik për menaxhimin me mbeturinat, lokacioni ku largohen mbeturinat (depozitimi)
Faza e ndërtimit	1	Mbeturinat e përziera komunale	20 03 01	Nuk mund të përcaktohet në këtë fazë ¹	Largimi i përkohshëm në kontejnerë dhe depozitimi në deponi	Ndërmarrja lokale komunale
	2	Mbeturinat organike (bimet, drunjë, kaçubet etj)	20 02	Sasia e saktë nuk mund të përcaktohet	Magazinimi i lokacionit të përcaktuar nga K.Konçe deri në dorëzimin final në NPK komunale	Ndërmarrja lokale komunale
	3	Mbeturinat ndërtimore nga aktivitetet ndërtimore	17 03 02	Sasia e saktë nuk mund të përcaktohet	Magazinimi në lokacionin përkatës deri në dërgimin në deponi për mbeturina ndërtimore	Ndërmarrja lokale komunale
	4	Material grithës	17 03 02	Sasia e saktë nuk mund të përcaktohet	Magazinimi në lokacionin përkatës deri në depozitim apo ripërdorim të rrugëve qasëse	Personi juridik apo fizik i autorizuar për të vepruar me lloj të tillë të mbeturinave
